



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 12207 Prot.

Tiranë, më 23 . 11 /2018

U D H Ë Z I M

Nr. 36 , datë 23 / 11 /2018

PËR

“DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 10.09.2018 “PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 8 të nenit 59, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

U D H Ë Z O N:

1. Në Kreun I të udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, bëhet shtesa e mëposhtme:
 - a) pas nënpikës “vii.” të shkronjës “b” të pikës 4, shtohet nënpika “viii.” si vijon:

“viii. Ndjekja dhe /ose drejtimi i praktikës mësimore/profesionale mjekësore për të gjitha ciklet e studimeve, për kategorinë personel akademik me kohë të plotë”.
2. Në Kreun II bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, togfjalëshi “sipas koeficientëve”, hiqet.
 - b) Pika 3 ndryshon si vijon:

“3. IAL-të mund të angazhojnë dhe personel akademik me kohë të pjesshme të dedikuar në veprimtari të kërkimit shkencor i cili nuk ka detyrim mësimdhënien, por që kontribuon në kërkimin shkencor sipas përcaktimeve në shkronjën “c” të pikës 4, të kreut I të këtij udhëzimi.”.
 - c) Në pikën 4, hiqet fjalia “Kjo ngarkesë nuk përfshihet në llogaritjet e orëve maksimale të pikës 8 të këtij udhëzimi”.
 - d) Pika 6 të riformulohet si vijon:

“6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë përmban 3 lëndë semestrale, në një vit akademik, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë.”.

e) Pas pikës 7, të shtohet pika “7.1” me këtë përmbajtje:

“7.1 Për personelin akademik me kohë të plotë në institut dhe qendër të kërkimit e zhvillimit, mësimdhënia vjetore do të jetë 20-30% e orëve mësimore, përkatësisht, sipas përcaktimeve të pikës 1 të kreut II, të këtij udhëzimi. Ky personel aktivizohet si rregull në fusha që përputhen me misionin e tyre. Për nevoja të veçanta të kërkimit, për këtë personel akademik mund të planifikohet mësimdhënie vjetore më e pakët”.

f) Pika 8, ndryshon si vijon:

“8. Doktorantët me kohë të plotë dhe që frekuentojnë vitin e dytë ose të tretë të studimeve të doktoratës mund të angazhohen në aktivitete mësimdhënëse mbështetëse jashtë auditorit sipas përcaktimeve të nënpikave “i.” dhe “ii.” të shkronjës “b” të pikës 4, të kreut I, si dhe në aktivitetet kërkimore sipas përcaktimeve të shkronjës “c” të pikës 4, të kreut I. Angazhimi i doktorantëve në aktivitetet mësimdhënëse të sipërcituara kryhet në kuadër të parashikimeve të programit përkatës të doktoratës nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të doktoratës dhe sipas nevojave të njësisë bazë dhe asaj kryesore.”

g) Në pikën 12, në fund të shkronjës “e” të shtohet:

“Ndjekja e 1 orë praktike klinike në mjekësi është 0.5 orë mësimore.
Praktikat mësimore/ profesionale mjekësore për të gjitha ciklet e studimeve, të cilat drejtohen nga mbikëqyrës klinik do të njësohen 12 orë me 1 orë mësimore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

